



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Rasti: Përftim kontrolli të vetëm/ 532- LUFTHANSA AG /AUSTRIAN AIRLINES AG

1. Në datën 12 Dhjetor 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin paraparak të transaksionit, që synonte në përftimin e kontrollit të pjesëshëm nga shoqëria Lufthansa AG (LH Gjermani) në shoqërinë Austrian Airlines AG (OS Austri) dhe që do të realizohej në dy faza. Hapi i parë është blerja e 41.56% të aksioneve në shoqërinë Austrian AirLines AG dhe hapi i dytë është përftimi i pjesëshëm i kontrollit deri në masën 75%, i cili do të realizohet nëpërmjet publikimit të ofertës publike të datës 27 shkurt 2009. Përqëndrimi i njoftuar konsiderohet si një transaksion i vetëm në zbatim të nenit 10, pika 1, shkronja b dhe neni 10, pika 2 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Njoftimi i plotë i përqendrimit, që përfshin të gjitha transaksionet e ndërmjetme, është depozituar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 26 Shkurt 2009.
2. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:
  - Për Lufthansa: transporti ajror i pasagjerëve, shërbimi kargo, catering, shërbimet e IT-së, mirëmbajtje dhe riparim avionësh;
  - Për Austria AirLines: transporti ajror i pasagjerëve, shërbimi kargo, catering, shërbimet e IT-së, mirëmbajtje dhe riparim avionësh.
3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Autoriteti vlerësoi që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit. Palët pjesëmarrëse në përqendrimin e njoftuar janë të pranishme në tregun e transportit ajror të pasagjerëve të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria Austrian Airlines AG është e pranishme edhe në ofrimin e shërbimit të transportit ajror kargo.
4. Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax 0355 4 2234 497, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [perqendrimi@caa.gov.al](mailto:perqendrimi@caa.gov.al)**

